



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) lidhur me nenin 40 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenet 2 dhe 8 lidhur me nenin 21 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.05/L-108, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 lidhur me nenin 34 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhja e mbajtur më 27 tetor 2023, Kuvendit i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 tetor 2023, mori këtë:

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim, të gjitha femrat e Komunës së Podujevës lirohen nga pagesa në shërbimin mjekësor Mamografi që ofrohet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Podujevë.

#### **Neni 2**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0079528/23  
Podujevë, datë: 31.10.2023

